



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1894/6 Prot

Tiranë, më 07.12.2022

VENDIM

Nr.59, datë 07.12.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1894 Prot., datë 02.11.2022, (saktësuar me nr. 1894/1 Prot., datë 07.11.2022), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, nëpërmjet e-mail-it datë 18.10.2022, depozituar në adresën nexhila.kodra@shendetesia.gov.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. Një kopje e dokumentit për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Çmimit për Barnat për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021,2022;
2. Një kopje të listës së barnave me çmimet CIF, të miratuara për vitet: 2014, 2015, 2016, 2017, 2019, 2020, 2021, 2022;
3. Sa fabrika të prodhimit të barnave janë licencuar në vend?
4. Sa kërkesa nga subjekte vendas dhe të huaj ka marrë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hapjen e fabrikave të prodhimit të barnave nga viti 2015-2022?
5. Një kopje e licencës së dhënë kompanive apo subjektive fizike për ndërtimin e fabrikave të prodhimit të barnave ne vend.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 4074/1 Prot., datë 31.10.2022, ka kthyer përgjigje duke cituar se: “...Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 01.10.2014 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, përcaktohet se Komisioni i Çmimit të Barnave kryesohet nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ka në përbërje, përfaqësues nga drejtoria përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, nga ministria përgjegjëse për financat, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe nga Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore”.

Në lidhje me listat e çmimeve të barnave të miratuara për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, ju bëjmë me dije se periudha kohore (prej 8 vitesh) e kërkuar është shumë e gjerë dhe listat përmbajnë një numër të konsiderueshëm barnash, formë dozash, paketimesh etj, ku grumbullimi dhe përgatitja e të cilave kërkojnë një punë voluminoze nga drejtoria përgjegjëse e ministrisë.

Për sa i përket kërkesës lidhur me subjektet e licencuara për prodhimin e barnave, në zbatim të nenit 20/5 të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, aplikimet për kategorinë për prodhim barnash për përdorim njerëzor, kalojnë përmes Qendrës Kombëtare të Biznesit pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë pasi kërkon inspektim nga ky institucion.

Aktualisht, të licensuara dhe me status aktiv për kategorinë II.7.C.1, për prodhim barnash për përdorim njerëzor janë 7 subjekte dhe nga viti 2015 deri në vitin 2022 pranë MSHMS-së, ka pasur 5 kërkesa të reja për t’u pajisur me licensë për këtë kategori.

Qendra Kombëtare e Biznesit është institucioni përgjegjës për lëshimin e licencave për këtë kategori, si pasojë, kopjen e licensave të subjekteve të licensuar për kategorinë në fjalë mund të aksesohet në faqen on-line të këtij institucioni.”

Në vijim, pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja pretendon se: “...në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 01.10.2014 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, listat e barnave me çmimet CIF, duhet të ishin publike dhe të aksesueshme në faqen on line të institucionit për çdo vit kalendarik. Gjithashtu, Autoriteti Publik nuk ka mundur të dhënien e asnjë dokumenti tjetër për sa i është kërkuar nëpërmjet e-mail-it datë 18.10.2022”.

Në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit sipas kërkesës për informacion depozituar nëpërmjet e-mail-it datë 18.10.2022.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të

përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri, me shkresën nr. 1894/2 prot., datë 08.11.2022, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar për secilën pikë, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 15.11.2022. Në vijim, nuk ka pasur asnjë reagim nga Autoriteti Publik.

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 24.11.2022 me prezencën e ankueses dhe përfaqësueses së Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në pikat 1, 2 dhe 5 të kërkesës për informacion të depozituar nëpërmjet e-mail-it datë 18.10.2022.

Ndërkohë, përfaqësuesja e Autoritetit Publik, sqaroi se kërkesa për informacion është konsideruar e trajtuar me përgjigjen e dhënë nëpërmjet shkresës nr. 4074/1 Prot., datë 31.10.2022. Gjithashtu, theksoi se qëllimi i Autoritetit Publik nuk është refuzimi i informacionit, por fakti se ky informacion është shumë voluminoz. Megjithatë, përfaqësuesja e Autoritetit Publik kërkoi kohë të konsultohet me strukturat përkatëse për të marrë një informacion më të saktë për fazën në të cilën ndodhet përgatitja e këtij informacioni.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, i la afat Autoritetit Publik, për të përcjellë qëndrimin përfundimtar lidhur me këtë çështje brenda datës 25.11.2022.

Në vijim, Autoriteti Publik me shkresën nr. 4361/1 Prot., datë 24.11.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1894/4 Prot., datë 25.11.2022, ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur, duke cituar se: “...kemi sjellë në vëmendje dhe ndërgjegjësuar kërkesën, lidhur me punën reale dhe voluminoze që konsiston kërkesa për informacion “Depozitimi i çmimit të barnave për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2019, 2020, 2021, 2022”, për shkak se duhet të nxirren që prej arkivës së vitit 2014 të gjitha shkresat e miratimit të këtyre çmimeve nga Komisioni i Çmimit të Barnave, referuar procedurës së parashikuar në VKM nr. 645, datë 01.10.2014 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të çmimit të barnave”, të ndryshuar...

Në kuptim të përgjigjes së kthyer, është gjykuar se me sqarimin e dhënë subjektit për situatën e punës voluminoze para së cilës do të duhej të ndodhemi, ajo mund të vijonte komunikimin me MSHMS dhe të shprehte në formë një kërkesë të detyrueshme të re vitin për çmimin CIF të miratuar të së cilit ka pasur më tepër interes për t’u njohur.

Gjithashtu sa më sipër, sjellim në vëmendje se me VKM nr.731, datë 16.11.2022, janë miratuar ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 1.10.2014 “Për

ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, dhe MSHMS nuk ngarkohet më tej me detyrimin për publikim të çmimit CIF.

Rrjedhimisht, si përfundim deklarojmë se ngelemi të hapur për të bashkëpunuar me kërkuesen në vijimësi për të vënë në dispozicion në një moment të përshtatshëm të dhënat që kërkohen. Ajo që MSHMS kërkon është dhënia e më shumë kohe me qëllim mirëorganizimin e punës për dhënien e informacionit pasi asnjëherë nuk ka pasur si qëllim mos dhënie informacioni.”

Në vijim, ankuesja, nëpërmjet e-mail-it datë 01.12.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1894/5 Prot., datë 01.12.2022, kërkon vijimin e ankimit dhe detyrimin e Autoritetit Publik të vendosë në dispozicion informacionin lidhur me pikat 1, 2 dhe 5, të kërkesës për informacion të depozituar nëpërmjet e-mail-it datë 18.10.2022.

Në këto kushte, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të informacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të sipërcituara, rezulton se Autoriteti Publik, ka përmbushur detyrimin duke vendosur në dispozicion informacionin lidhur me pikat 3 dhe 4 të kërkesës për informacion, për të cilën nga ana e ankueses nuk është vijuar me ankim.

Ndërkohë, për sa i përket pikës 1 të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik ka informuar mbi përbërjen/institucionin përgjegjës nga ku caktohet çdo anëtar i Komisionit të Çmimit të Barnave sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 01.10.2014 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, por nuk ka vendosur në dispozicion kopje të dokumentit sipas pikës 1 të kërkesës për informacion (*Një kopje e dokumentit për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Çmimit për Barnat për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022*), duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesën për informacion për të cilën është depozituar edhe ankesa.

Lidhur me pikën 2 të kërkesës për informacion në të cilën kërkohet *Një kopje e listës së barnave me çmimet CIF, të miratuara për vitet: 2014, 2015, 2016, 2017, 2019, 2020, 2021, 2022*, Autoriteti Publik pretendon se *informacioni i kërkuar është voluminoz dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.731, datë 16.11.2022, ku janë miratuar ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 1.10.2014 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ngarkohet më tej me detyrimin për publikim të çmimit CIF.*

Komisioneri lidhur me këtë pretendim vlerëson se, ky qëndrim bie ndesh me qëllimin e LDI i cili është garantimi i njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike. Komisioneri, megjithëse mirëkupton situatën e pretenduar nga Autoriteti Publik, për shkak të punës voluminoze, nuk

përbashkon në asnjë moment këtë të fundit nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konstatohet se Autoriteti Publik ka pasur kohën e mjaftueshme për të vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar.

Konkretisht, afati i marrjes së informacionit është përcaktuar në nenin 15 të LDI, ku në pikën 1 të tij parashikohet se:

“1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe”.

Gjithashtu, në pikën 3 të këtij neni parashikohet se:

“3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;

b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;

c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për

plotësimin ose jo të kërkesës.

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit.

Komisioneri gjithashtu vlerëson se, informacioni i kërkuar (Listat e barnave me çmimet CIF për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2019, 2020, 2021 dhe 2022), duhet të ishte publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit Publik, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti në zbatim të nenit 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 1.10.2014 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të çmimit të barnave”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se:

“Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen në faqen zyrtare të ministrisë, të listës së përgjithshme me çmimet “CIF/EXW”, të miratuar nga komisioni”.

Ndërkohë, argumenti i Autoritetit Publik se në VKM nr. 731, datë 16.11.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 645, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të çmimit të barnave”, e cila ka ndryshuar VKM-në sipërcituar, ky i fundit nuk ngarkohet më tej me detyrimin për publikim të çmimit CIF, qëndron për listën e barnave me çmimet CIF që do të miratohen në vijim, i cili nuk është objekt ankimi.

Konkretisht në këtë VKM parashikohet se: *“17. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, dërgon pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor listën e përgjithshme me çmimet “CIF/EXW”, të miratuar nga komisioni”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur Autoriteti Publik pranon zotërimin e informacionit objekt ankese, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e*

regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.

Bazuar në këtë dispozitë Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuases/ankueses informacionin në formatin e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Ndërkohë lidhur me pikën e 5 të kërkesës për informacion *Një kopje e licencës së dhënë kompanive apo subjektive fizike për ndërtimin e fabrikave të prodhimit të barnave ne vend, Komisioneri e gjen të pabazuar përgjigjen se, Qendra Kombëtare e Biznesit është institucioni përgjegjës për lëshimin e licencave për këtë kategori, si pasojë, kopjen e licensave të subjekteve të licensuar për kategorinë në fjalë mund të aksesohet në faqen on-line të këtij institucioni, për shkak se Autoriteti Publik nuk rezulton që të ketë trajtuar kërkesën për informacion, në bazë të pikave 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI, në të cilën parashikohet se:*

2. “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin.

3. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”

Gjithashtu, konstatohet se kërkuases/ankueses i është cituar vetëm faqja zyrtare e institucionit ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresa e saktë e faqes ku ndodhet informacioni, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se:

2. “Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

Kërkuësja/ankuesja është gazetares, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t'i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1894 Prot., datë 02.11.2022, nga znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikave 1, 2 dhe 5 të kërkesës për informacion, depozituar nëpërmjet e-mail-it datë 18.10.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 15.12.2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 07.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi